



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

**RREGULLORE (QRK) NR. 03/2026 PËR PROCEDURËN
E SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TË AKTEVE TË
KOMUNAVE¹**

¹ Rregullore (QRK) Nr. 03/2026 për rocedurën e shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, është miratuar në mbledhjen e 08-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 08/02, të datës 20.02.2026.

Qeveria e Republikës së Kosovës

Në mbështetje të nenit 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 5, paragrafi 4, neni 9, paragrafi 5, neni 10, paragrafi 7, neni 13, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (GZ, Nr. 24/2024, 27.12.2024), neni 8, paragrafit 4, nënparagrafi 4.5, të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 34/2022, 18.11.2022):

Nxjerr:

RREGULLORE (QRK) NR.03/2026 PËR PROCEDURËN E SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TË AKTEVE TË KOMUNAVE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi i procedurave për shqyrtimin e detyrueshëm të ligjshmërisë, shqyrtimin e rregullt të ligjshmërisë, shqyrtimin e përshtatshmërisë së akteve të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit të Komunës si dhe procesin e konsultimit paraprak, për të siguruar se të njëjtat janë në pajtim me ligjin dhe Kushtetutën.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj rregullore zbatohen nga Komunat, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë e Linjës dhe organet e tjera përgjegjëse për procesin e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si në vijim:

1.1. **Organi mbikëqyrës** - nënkupton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrinë tjetra të linjës si dhe organet tjera përgjegjëse për shqyrtimin e ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë të akteve të komunës, të përcaktuara në nenin 4, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave;

1.2. **Ministria** - nënkupton Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;

1.3. **Ministritë e linjës dhe organet tjera përgjegjëse** - nënkupton Ministritë e linjës dhe organet tjera përgjegjëse, kompetente për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të komunave;

1.4. **Aktet e komunës** - nënkupton të gjitha aktet të cilat miratohen nga Kuvendi i Komunës si dhe aktet të cilat nxirren nga Kryetari i Komunës në pajtim me legjislacionin në fuqi;

1.5. **Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë** - nënkupton shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës të përcaktuara në nenin 8, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave;

1.6. **Shqyrtimi i rregullt i ligjshmërisë** - nënkupton shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të komunës të miratuara nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës, në pajtim me nenin 10, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave;

1.7. **Shqyrtimi i përshtatshmërisë** - nënkupton shqyrtimin e ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së akteve të komunës të miratuara për zbatimin e kompetencave të deleguara, në pajtim me nenin 11, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave;

1.8. **Konsultimi paraprak** - nënkupton të drejtën e organeve të komunës për konsultim me organin mbikëqyrës, para miratimit të një akti të komunës në pajtim me nenin 5, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave;

1.9. **Organet e komunës** - nënkupton Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës;

1.10. **NJAD** - nënkupton Njësinë për Administrimin e Dokumenteve në Ministri;

2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë Rregullore, kanë kuptimin e dhënë në Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe legjislacionin përkatës për vetëqeverisje lokale në Kosovë.

Neni 4

Procedura për konsultim paraprak

1. Para nxjerrjes apo miratimit të një akti juridik, organet e komunës kanë të drejtë të kërkojnë konsultim paraprak nga organi mbikëqyrës, me qëllim të vlerësimit të përputhshmërisë së projekt-aktit me legjislacionin në fuqi.

2. Kërkesa për konsultim paraprak paraqitet në formë të shkruar nga:
 - 2.1 Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, në rastet kur akti iniciohet nga Kuvendi; ose
 - 2.2 Kryetari i Komunës, në rastet kur akti iniciohet nga organet e ekzekutivit të Komunës.
3. Kërkesa për konsultim paraprak dërgohet bashkë me projekt-aktin, duke identifikuar çështjen e posaçme për të cilat kërkohet konsultimi paraprak nga organi mbikëqyrës.
4. Kërkesa për konsultim paraprak pranohet nga Ministria përmes NJAD, e cila pas pranimiit e protokollon dhe e dërgon tek njësia përkatëse për shqyrtim.
5. Ministria përgatitë opinionin dhe ia dërgon organit të komunës që ka kërkuar konsultim paraprak jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimiit të kërkesës.
6. Në rast se Ministria vlerëson se çështja për të cilën kërkohet konsultimi paraprak është kompetencë ligjore e Ministrisë e linjës dhe organeve tjera përgjegjëse, brenda tre (3) ditësh, do t'ia dërgojë kërkesën Ministrisë së linjës ose organit tjetër përgjegjës.
7. Ministria e linjës, apo organi tjetër përgjegjës, jo me vonë se njëzeteshtatë (27) ditë nga dita e pranimiit, përgatitë opinionin dhe ia dërgon organit të komunës që ka kërkuar konsultim paraprak duke njoftuar edhe Ministrinë.
8. Ministria publikon opinionin për çdo konsultim paraprak në ueb-faqen zyrtare.

Neni 5

Dërgimi i akteve

1. Komuna është e obliguar t'ia dërgoj aktet e miratuara të Kuvendit të Komunës për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë në Ministri brenda shtatë (7) ditëve nga dita e miratimit të tyre.
2. Kryetari i Komunës obligohet t'ia dërgoj Ministrisë listën e të gjitha akteve të miratuara nga organet e komunës gjatë muajit paraprak, jo me vonë se deri më datën 10 të çdo muaji vijues, të cilat ju nënshtrohen shqyrtimit të rregullt të ligjshmërisë.
3. Aktet dhe lista e akteve nga komuna dërgohet në gjuhë zyrtare në përputhje me ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare përmes NJAD.

Neni 6

Pranimi i akteve të komunës

1. Pranimi i akteve të komunave, bëhet përmes NJAD në Ministri, e cila i pranon, evidenton, protokollon, klasifikon aktet e komunës si dhe listën e akteve të komunës.
2. Aktet e komunave prانهen nga NJAD në formë fizike apo elektronike. Pas pranimiit, NJAD lëshon një dëshmi zyrtare që vërteton marrjen e dokumenteve.

3. Pas evidentimit dhe protokollimit, aktet dhe listën e akteve, NJAD i dërgon në njësinë përkatëse të Ministrisë.

4. Me qëllim të përcaktimit të afateve kohore për shqyrtimin e ligjshmërisë dhe përshtatshmërisë së akteve të komunës, data e protokollimit të akteve të komunës nga NJAD e Ministrisë konsiderohet datë e pranimit të akteve të komunës.

Neni 7

Rregullat e përgjithshme të shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunës

1. Ministria është përgjegjëse për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të komunës për fushat, për të cilën ajo shërben si organ mbikëqyrës si dhe për koordinimin e procesit të shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunës.

2. Për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të komunës për fusha për mbikëqyrjen e të cilave nuk është kompetente Ministria, përgjegjëse janë Ministrinë e linjës apo organet tjera përgjegjëse.

3. Ministria, pas pranimit të akteve nga komuna, përcakton Ministrinë e linjës apo organin tjetër përgjegjës dhe e dërgon aktin për shqyrtim të ligjshmërisë.

4. Ministrinë e linjës, organet tjera përgjegjëse, bëjnë shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të komunës si në vijim:

4.1 Aktet në fushën e financave, menaxhimit të buxhetit të komunës dhe tatimin në pronë, Ministria përgjegjëse për financa;

4.2 Aktet në fushën e zhvillimit lokal ekonomik, ofrimin e shërbimeve publike nga ndërmarrjet publike, Ministria përgjegjëse për ekonomi;

4.3 Aktet në fushën e planifikimit urban dhe rural, ndërtimit, mbrojtjen e mjedisit lokal, banimin publik, emërimin e rrugëve dhe vendeve tjera publike, Ministria përgjegjëse për planifikim hapësinor;

4.4 Aktet në fushën e bujqësisë, pylltarisë, zhvillimit rural dhe shfrytëzimit të tokës, Ministria përgjegjëse për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural;

4.5 Aktet në fushën e emergjencave lokale dhe gjendjen civile, Ministria përgjegjëse e punëve të brendshme;

4.6 Aktet në fushën e arsimit, Ministria përgjegjëse e arsimit;

4.7 Aktet në fushën e shëndetësisë, Ministria përgjegjëse për shëndetësi;

4.8 Aktet në fushën e punës dhe mirëqenies sociale, Ministria përgjegjëse për punë dhe mirëqenie sociale;

4.9 Aktet në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, Ministria përgjegjëse për kulturë, rini dhe sport;

4.10 Aktet në fushën e transportit publik lokal, Ministria përgjegjëse për infrastrukturë;

4.11 Aktet në fushën e tregtisë dhe turizmit lokal, Ministria përgjegjëse për tregti dhe industri;

4.12 Aktet në fushën e komuniteteve dhe kthimit, Ministria përgjegjëse për komunitete dhe kthim.

5. Aktet të cilat nuk janë përfshirë në paragrafin 4 të këtij neni, varësisht nga fusha, Ministria e dërgon te Ministria e linjës apo organi tjetër përgjegjës, për shqyrtimin të ligjshmërisë.

6. Nëse nuk mund të përcaktohet se cila është Ministria e linjës apo organi tjetër përgjegjës sipas paragrafit 4 të këtij neni, Ministria krijon një komision Ad-Hoc prej tre (3) anëtarësh, i cili do të shqyrtoj aktin për të cilin bëhet shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë.

7. Në rastet kur një akt prek fushat e dy ose më shumë Ministrive të linjës, apo organeve tjera përgjegjëse secila Ministri e linjës apo organ tjetër përgjegjës e vlerëson aktin nga fusha e vet dhe i dërgohet raporti Ministrisë, e cila finalizon vlerësimin e ligjshmërisë dhe raportin e dërgon te komuna.

Neni 8

Aktet që i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë

1. Aktet e Kuvendit të Komunës që i nënshtrohen shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë janë:

1.1 Statutet;

1.2 Rregulloret e komunës;

1.3 Vendimet e përgjithshme të Kuvendit të Komunës, përjashtimisht rasteve kur shqyrtimi i ligjshmërisë së vendimeve individuale parashihet me legjislacion të veçantë;

1.4 Marrëveshjet për bashkëpunim ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar;

1.5 Dokumentet e planifikimit hapësinor lokal.

Neni 9

Përgjegjësitë dhe procedura e shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë

1. Organet mbikëqyrëse janë përgjegjëse për shqyrtimin e detyrueshëm të ligjshmërisë së akteve të komunës brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të aktit nga komuna.

2. Ministria është përgjegjëse për koordinimin e procesit të shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të komunës, për të cilat përgjegjëse për shqyrtim janë Ministrinë e linjës, organet tjera përgjegjëse, sipas procedurës në vijim:

2.1 Ministria, jo më vonë se pesë (5) ditë nga data e pranimit të aktit të komunës, me shkresë përcjellëse do të dërgoj aktin në Ministrinë e linjës apo organin tjetër përgjegjës për shqyrtimin e ligjshmërisë;

2.2 Ministria e linjës apo organi tjetër përgjegjës brenda njëzetë e pesë (25) ditëve, shqyrton ligjshmërinë e aktit të komunës dhe të njëjtin i dërgon komunës duke e njoftuar edhe Ministrinë.

3. Organi mbikëqyrës ka të drejtë të kërkojë nga komuna dokumente ose informacione shtesë, para se të bëjë vlerësimin e ligjshmërisë së çdo akti të regjistruar. Nëse komuna nuk dërgon dokumentet apo informacionet shtesë brenda afatit prej tre (3) ditëve, organi mbikëqyrës vlerëson se akti nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi.

4. Nëse organi mbikëqyrës konsideron se akti i komunës është në pajtim me legjislacionin në fuqi, përgatit opinionin e ligjshmërisë me të cilin konstaton se akti është në pajtim me legjislacionin në fuqi.

5. Nëse organi mbikëqyrës konsideron se një akt i komunës nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, ai mund të kërkojë që komuna të rishqyrtojë aktin. Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë arsyet e supozuara të shkeljes së Kushtetutës apo ligjit dhe nuk suspendon ekzekutimin e aktit.

6. Komuna i përgjigjet kërkesës së organit mbikëqyrës për rishqyrtimin e aktit brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të kërkesës.

7. Nëse komuna nuk e rishqyrton aktin brenda tridhjetë (30) ditëve nga pranimi i kërkesës për rishqyrtim, organi mbikëqyrës pas konstatimit të mosveprimit nga komuna, brenda tridhjetë (30) ditëve përgatit shkresën për Avokaturën Shtetërore që të paraqet padi në gjykatën kompetente.

8. Organi mbikëqyrës varësisht nga fusha është përgjegjës të përgatit shkresën për Avokaturën Shtetërore që të paraqet padi në gjykatën kompetente. Ministrinë e linjës apo organet e tjera përgjegjëse, duhet të njoftojnë dhe Ministrinë, për shkresat të cilat dërgohen në Avokaturë Shtetërore.

Neni 10

Shqyrtimi i rregullt i ligjshmërisë

1. Kryetari i Komunës i dërgon Ministrisë listën e akteve të miratuara nga Kuvendi dhe Kryetari nga muaji paraprak deri me datën 10 të çdo muaji vijues.

2. Ministria ka të drejtë të zgjedh nga lista se cili prej akteve do t'i nënshtrohet shqyrtimit të rregullt të ligjshmërisë.

3. Ministria ka të drejtë të kërkojë nga Kryetari i Komunës të dërgoj për shqyrtim të ligjshmërisë çdo akt i cili i nënshtrohet shqyrtimit të rregullt të ligjshmërisë.

4. Komuna publikon në ueb-faqen zyrtare të saj listën e akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës nga muaji paraprak.

5. Në bazë të fushëveprimtarisë së tyre, Ministrinë e linjës dhe organet tjera përgjegjëse, përmes Ministrisë kanë të drejtë të zgjedhin nga lista e publikuar e akteve se cili prej akteve do t'i nënshtrohet shqyrtimit të rregullt të ligjshmërisë.

6. Procedura e shqyrtimit të rregullt të ligjshmërisë është e njëjtë me atë të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë të përcaktuar në nenin 8 dhe 9 të kësaj Rregulloreje.

7. Afati për shqyrtimin e rregullt të ligjshmërisë së aktit është tridhjetë (30) ditë nga dita e pranimi të aktit nga komuna.

Neni 11

Shqyrtimi i përshtatshmërisë

Shqyrtimi i aktit të komunës për kompetencat e deleguara ushtrohet nga autoriteti mbikëqyrës për kompetenca të deleguara, ashtu siç është përcaktuar në nenin 11, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Neni 12

Përgjegjësia për koordinim dhe raportim

1. Ministria është përgjegjëse për koordinimin dhe raportimin vjetor lidhur me mbikëqyrjen e ligjshmërisë së akteve të organeve të komunës.

2. Ministrinë e linjës dhe organet tjera përgjegjëse e informojnë Ministrinë, në baza vjetore lidhur me vlerësimin e ligjshmërisë së akteve nga fusha e tyre.

3. Ministria dërgon raportin vjetor lidhur me vlerësimin e akteve të komunave në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

Neni 13

Shtojca e kësaj Rregulloreje

1. Pjesë e kësaj Rregulloreje është shtojca I (formatet) si në vijim:

1.1 Format i shkresave për konsultim paraprak;

1.2 Format i shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë nga MAPL - konfirmimi i ligjshmërisë;

1.3 Format i shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë nga MAPL - kërkesa për rishqyrtimin e ligjshmërisë;

1.4 Format i shqyrtimit të rregullt të ligjshmërisë së akteve të KK dhe Kryetarit të Komunës nga MAPL - konfirmimi i ligjshmërisë;

1.5 Format i shqyrtimit të rregullt të ligjshmërisë së akteve të KK dhe Kryetarit të Komunës nga MAPL - kërkesa për rishqyrtimin e ligjshmërisë;

1.6 Formati për dërgimin e akteve në Ministritë e linjës për shqyrtimin e ligjshmërisë;

1.7 Formati për shqyrtimin e detyrueshëm të ligjshmërisë nga Ministritë e linjës - konfirmimi i ligjshmërisë;

1.8 Formati për shqyrtimin e detyrueshëm të ligjshmërisë nga Ministritë e linjës - kërkesa për rishqyrtimin e ligjshmërisë;

1.9 Formati për shqyrtimin e rregullt të ligjshmërisë së akteve të KK dhe Kryetarit të Komunës nga Ministritë e linjës - konfirmimi i ligjshmërisë;

1.10 Formati për shqyrtimin e rregullt të ligjshmërisë së akteve të KK dhe Kryetarit të Komunës nga Ministritë e linjës - kërkesa për rishqyrtimin e ligjshmërisë.

Neni 14 Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e datës 07.08.2019 dhe Rregullorja (QRK) Nr. 06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësim e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e datës 26.10.2021.

Neni 15 Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

20. shkurt.2026

Shtojca I

1.1 Formati i shkresave për konsultim paraprak



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Emri dhe Mbiemri, Kryetar i Komunës _____ Emri dhe Mbiemri, Kryesues i Kuvendit të Komunës _____	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i _____ Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë _____	
Nga:	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor	Datë: ____/____/____
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqësi i Divizionit përgjegjës për vlerësim	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, pozita e zyrtarit përgjegjës për vlerësim të ligjshmërisë	
Lënda:	Përgjigje në kërkesën për konsultim paraprak	
Lloji i aktit:	☐ Statut i Komunës ☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ Akt tjetër i Komunës _____	

I nderuar Kryetar

I nderuar Kryesues

Në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (GZ Nr. 24/2024 dhjetor 2024) dhe Rregulloren (QRK) Nr. ____ për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së _____ (____) ka pranuar kërkesën për konsultim paraprak ashtu siç parashihet në nenin 5, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave (GZ Nr. 24/2024 dhjetor 2024) nga Komuna e _____, lidhur me draft - aktin përkatësisht dispozitën ligjore të aktit të komunës si në vijim:

Statuti Nr. _____ për _____ Rregullorja e Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____ Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____ Akti tjetër i Komunës _____
I parashtruar për konsultim paraprak në MAPL më datë: _____
I dërguar për konsultim paraprak në _____ (____) më datë: _____

Ministria e _____, pas shqyrtimit të kërkesës për konsultim paraprak të përmbajtjes së draft-aktit të komunës si më sipër, këshillon komunën që draft - akti i synuar të nxjerrët të përmbaj:

_____.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Emri dhe Mbiemri, Kryetar i Komunës së _____ Emri dhe Mbiemri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së _____	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i MAPL-së Emri dhe Mbiemri, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor	Datë: ____/____/____
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Divizionit përgjegjës për vlerësim	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, Pozita e zyrtarit përgjegjës për vlerësim të ligjshmërisë	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë e aktit të komunës së _____	
Lloji i aktit:	☐ Statut i Komunës ☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ Akt tjetër i Komunës: _____	

I nderuar Kryetar
 I nderuar Kryesues

Në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. ____ për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 8 dhe 9, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave aktin e komunës në vijim:

Statuti Nr. _____ për _____
Rregullorja e Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Akti tjetër i Komunës _____
I miratuar më datë: _____
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: _____

Ministria e _____, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

ARSYETIM

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

1.3 Formati për shqyrtimin e detyrueshëm të ligjshmërisë nga MAPL - kërkesa për rishqyrtimin e ligjshmërisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Emri dhe Mbiemri, Kryetar i Komunës së _____ Emri dhe Mbiemri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së _____	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njesisë për administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i MAPL-së Emri dhe Mbiemri, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së	
Nga:	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor	Datë: ____/____/____
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Divizionit përgjegjës për vlerësim	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, pozita e zyrtarit përgjegjës për vlerësim të ligjshmërisë	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë e aktit të komunës së _____	
Lloji i aktit:	☐ Statut i Komunës ☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ Akt tjetër i Komunës: _____	

I nderuar Kryetar

I nderuar Kryesues

Në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. ____ për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe të Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 8 dhe 9, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave aktin e komunës në vijim:

Statuti Nr. _____ për _____
Rregullorja e Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Akti tjetër i Komunës: _____
I miratuar më datë: _____
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: _____

Ministria e _____, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

ARSYETIM

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

1.4 Formati për shqyrtimin e rregullt të ligjshmërisë së akteve të KK dhe Kryetarit të Komunës nga MAPL
- konfirmimi i ligjshmërisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Emri dhe Mbiemri, Kryetar i Komunës _____ Emri dhe Mbiemri, Kryesues i Kuvendit të Komunës _____	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i _____ Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë _____	
Nga:	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor	Datë: ____/____/____
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Divizionit përgjegjës për vlerësim	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, pozita e zyrtarit përgjegjës për vlerësim të ligjshmërisë	
Lënda:	Shqyrtimi rregullt i ligjshmërisë së aktit të Kuvendit/Kryetarit të Komunës së	
Lloji i aktit:	☐ Statut i Komunës ☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kryetarit të Komunës ☐ Akt tjetër i Komunës: _____	

I nderuar Kryetar

I nderuar Kryesues

Në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. ____ për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor, i Ministrisë së _____ (____) ka pranuar për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

Statuti Nr. _____ për _____
Rregullorja e Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Akti tjetër i komunës: _____
I miratuar më datë:
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë:
I dërguar për shqyrtim në Ministrinë _____ (__) më datë:

Ministria e _____, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

ARSYETIM

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

1.5 Formati për shqyrtimin e rregullt të ligjshmërisë së akteve të KK dhe Kryetarit të Komunës nga nga MAPL - kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Emri dhe Mbiemri, Kryetar i Komunës _____ Emri dhe Mbiemri, Kryesues i Kuvendit të Komunës _____	
Kopje:	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i _____ Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë _____	
Nga:	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, Ministria e	Datë: __/__/__
Zyrtarët përgjegjës:	1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor Emri dhe Mbiemri, udhëheqës i Divizionit përgjegjës për vlerësim 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor Emri dhe Mbiemri, pozita e zyrtarit përgjegjës për vlerësim të ligjshmërisë	
Lënda:	Vlerësimi i rregullt i ligjshmërisë	
Lloji i aktit:	☐ Statut i Komunës ☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kryetarit të Komunës ☐ Akt tjetër i komunës: _____	

I nderuar Kryetar
 I nderuar Kryesues

Në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr.____ për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

Statuti Nr. _____ për _____
Rregullorja e Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Akti tjetër i komunës: _____
I miratuar më datë: _____
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: _____

Ministria e _____, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

ARSYETIM

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Emri dhe Mbiemri, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së linjës (Nëse kompetente janë dy (2) apo më shumë Ministri të linjës, vendosen Sekretarët e Përgjithshëm të Ministrive të linjës)	
Kopje:	Kryetari i Komunës së _____ Kryesues i Kuvendit të Komunës së _____ Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Emri dhe Mbiemri, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor	Datë: __/__/____ Nr.
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Divizionit përgjegjës për vlerësim	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, pozita e zyrtarit përgjegjës për vlerësim të ligjshmërisë	
Lënda:	Kërkesë për shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të komunës së _____	
Lloji i aktit:	☐ Statut i Komunës ☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ Akt tjetër i Komunës _____	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar, _____, e/i miratuar nga Kuvendi i Komunës së _____, dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së _____, me qellim të shqyrtimit të detyrueshëm/rregullt të ligjshmërisë, ashtu siç parashihet me nenin __, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave.

Duke u bazuar në nenin __, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, dhe nenin __, të Rregullores (QRK) Nr. ____ për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmërisë, aktin e komunës si në vijim:

Statuti Nr. ____ për _____
Rregullorja e Kuvendit të Komunës Nr. ____ për _____
Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. ____ për _____
Akti tjetër i Komunës: _____
I miratuar më datë:
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë:
I dërguar për shqyrtim në Ministrinë ____ (__) më datë:



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Emri dhe Mbiemri, Kryetar i Komunës së _____ Emri dhe Mbiemri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së _____	
Kopje:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i MAPL-së Emri dhe Mbiemri, Sekretar i Përgjithshëm, MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i ministrisë së linjës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së linjës	
Nga:	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, Ministria e _____ linjës	Datë: __/__/__
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Divizionit përgjegjës për vlerësim	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, pozita e zyrtarit përgjegjës për vlerësim të ligjshmërisë	
Lënda:	Konfirmimi i ligjshmërisë së aktit të komunës së _____	
Lloji i aktit:	☐ Statut i Komunës ☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ Akt tjetër i Komunës: _____	

I nderuar Kryetar

I nderuar Kryesues

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. __ për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së _____ (__) ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

Statuti Nr. _____ për _____
Rregullorja e Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Akti tjetër i Komunës: _____
I miratuar më datë: _____
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: _____
I dërguar për shqyrtim në Ministrinë _____ (__) më datë: _____

Ministria e _____, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

ARSYETIM

_____.

Ministria e _____, mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Emri dhe Mbiemri, Kryetar i Komunës së _____ Emri dhe Mbiemri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së _____	
Kopje:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i MAPL-së Emri dhe Mbiemri, Sekretar i Përgjithshëm, MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i ministrisë së linjës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së linjës	
Nga:	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, Ministria e linjës	Datë: __/__/____
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zytari konfirmues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, udhëheqës i Divizionit përgjegjës për vlerësim	
2. Zytari hartues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, pozita e zyrtarit përgjegjës për vlerësim të ligjshmërisë	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë e aktit të komunës së _____	
Lloji i aktit:	☐ Statut i Komunës ☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ Akt tjetër i Komunës _____	

I nderuar Kryetar
 I nderuar Kryesues

Në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr. ____ për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor i Ministrisë së _____ (__) ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 9 dhe 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

Statuti Nr. _____ për _____
Rregullorja e Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____
Akti tjetër i Komunës: _____
I miratuar më datë: _____
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: _____
I dërguar për shqyrtim në Ministrinë _____ (__) më datë: _____

Ministria e _____, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

ARSYETIM

_____.

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e _____ kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimi të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e _____, mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Emri dhe Mbiemri, Kryetar i Komunës së _____ Emri dhe Mbiemri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së _____	
Kopje:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i MAPL-së Emri dhe Mbiemri, Sekretar i Përgjithshëm, MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i ministrisë së linjës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së linjës	
Nga:	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, Ministria e linjës	Datë: __/__/____
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, udhëheqës i Divizionit përgjegjës për vlerësim	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, pozita e zyrtarit përgjegjës për vlerësim të ligjshmërisë	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë e aktit të komunës së _____	
Lloji i aktit:	☐ Statut i Komunës ☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ Akt tjetër i Komunës _____	

I nderuar Kryetar

I nderuar Kryesues

Në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. ____ për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor, i Ministrisë së _____ (__) ka pranuar për shqyrtim të rregullt të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

Statuti Nr. _____ për _____ Rregullorja e Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____ Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. _____ për _____ Akti tjetër i komunës: _____
I miratuar më datë:
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë:
I dërguar për shqyrtim në Ministrinë _____ (__) më datë:

Ministria e _____, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **nuk është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi** dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

ARSYETIM

_____.

Ministria e _____, mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.

1.10 Formati për shqyrtimin e rregullt të ligjshmërisë së akteve të KK dhe Kryetarit të Komunës nga Ministrinë e linjës - Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Për:	Emri dhe Mbiemri, Kryetar i Komunës së _____ Emri dhe Mbiemri, Kryesues i Kuvendit të Komunës së _____	
Kopje:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i MAPL-së Emri dhe Mbiemri, Sekretar i Përgjithshëm, MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Emri dhe Mbiemri, Ministër i ministrisë së linjës Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së linjës	
Nga:	Emri dhe Mbiemri, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, Ministria e linjës	Datë: __/__/__
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, udhëheqës i Divizionit përgjegjës për vlerësim	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Emri dhe Mbiemri, pozita e zyrtarit përgjegjës për vlerësim të ligjshmërisë	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë e aktit të komunës së _____	
Lloji i aktit:	☐ Statut i Komunës ☐ Rregullore e Kuvendit të Komunës ☐ Vendim i Kuvendit të Komunës ☐ Akt tjetër i Komunës _____	

I nderuar Kryetar
I nderuar Kryesues

Në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. ____ për përcaktimin e procedurave për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregullores (QRK) - Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 10, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, aktin e komunës në vijim:

Statuti Nr. ____ për _____ Rregullorja e Kuvendit të Komunës Nr. ____ për _____ Vendimi i Kuvendit të Komunës Nr. ____ për _____ Akti tjetër i komunës: _____
I miratuar më datë: _____
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: _____

Ministria e _____, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.**

ARSYETIM

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e _____, mbetet në dispozicion të MAPL-së dhe komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.